



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Mbledhja e radhes e Këshillit Bashkiak Muaji SHKURT mbajtur sot me datë 28/02/2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Visarion Bici, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini, Visarion Bici.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjesë në mbledhje Kryetari i Bashkisë, z. Besion Ajazi.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjës të drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

**E.Zani:** Pershendetje të nderuar këshilltare sipas rendit të ditës kemi 3 pika për shqyrtim. Para se të fillojmë bëjmë një thirrje për komisionet, është e disata here që thirren dhe nuk mbledhen dhe është një përgjegjësi përball qytetarëve. Hedhim në votim rendin e ditës?

\*Miratohet rendi ditës me 11 Vota PRO.

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit

Xhullia Gjini

Kryetari Këshillit

Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamërb Dermvchi" Rruga "10 Korrik" T. 0513 3 3333 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Fatbardh Cekrezi  
Enis Zani  
Kujtim Brahimi

## Çështja 1

1- Për dhenien e ndihmes ekonomike per muajin Janar (Fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Visarion Bici, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kujtim Brahim, Alfrida Shahini, Visarion Bici.

Pergj.Ndh,Ek: Besoj jeni njohur me materialin.Per muajin Janar jane gjeneruar 36 familje per te perfituar nga fondi 6%

E.Zani: E do njeri fjalen? Hedhim ne votim?


\*Miratohet pika 1 e rendit te ditës me 11 Vota PRO

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit

Xhulia Gjini



Fatbardh Cekrezi

Kryetari Këshillit

Enis Zani



Ezeld Gausa Kujtim Brahim

## Çështja 2

- 2- Për miratimin e sistemit të pikëzimit për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga programet sociale të strehimit(Subvencionimi i qerasënë tregun e lirë).

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Visarion Bici, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini, Visarion Bici.

**Pergj.sek emergj.civile:** Ne baze te ligjit 22 per strehimin, drejtorja ka per detyre hartimin e planit 5 vjecar. Besoj jeni njohur me programin, nese keni ndonje pyetje?

**E.Carciu:** Kjo eshte nje ceshtje sensitive ,keshilli le te ngreje nje komision verifikimi per te patur transparence mes te gjitha paleve.

**E.Zani:**Keni pyetje?

**K.Bashkise:** Lidhur me programin eshte detyrim ligjor, ne lidhje me permiresimin e banesave eshte ndjekur nje procedure shume strikte, bashkia ben pranimin e dokumentave te cilat I sheh nese jane ne perputhje me kriteret ligjore te vendosura nga Ministria.

(Vjen ne mbledhje K.Cala)

**\*Marrin pjese 12 keshilltare ne mbledhje.**

Eshte bere nje pune voluminoze, mbi 6-muaj pune. Bonusin ne e trajtojme cdo vit, edhe kredite e buta,kush ka plotesuar kriteret ka perfitur. Gjithashtu parimisht na eshte pranuar kerkesa per ndertim te ten je pallati ose nje lagjeje me palate te vogla nga Enti I banesave, per tu ardhur ne ndihme familjeve te pastreha.

**F.Cekrezi:** Para disa viteve kemi miratuar planin e pergjithshem vendor.

**K.Bashkise:** Ne kemi disa muaj qe kemi cuar nje dosje te plote per ndryshim te planit te pergjithshem vendor. Sipas planit te vjeter nuk lejohen ,sidomos ne boulevard,ndertimet e larta. Edhe kete pjese e kemi,kerkuar te ndryshohet te plani, per kete process eshte kopotent AZHK. Ti japim zgjidhje strehimit port e ruajme edhe strukturen ndertuese te qytetit. Jemi ne mardhenie me institucionet ne Tirane per ndryshimin e pjesshem te planit vendor.

**F.Cekrezi:** Familjet e strehuara te ish-shiku, sipas informacioneve jane kthyer 3 dosje per mungese dokumentacioni, dhe sipas Keshillit te Ministrave do kthehet prone e bashkise.

**K.Bashkise:** Eshte ende ne process te Keshilli i Ministrave.

**K.Brahimi:** Jam shume dakort me materialin,ka shume familje e duhen ndihmuar dhe pengesa kryesore eshte certifikata e pronesise, si gjen zgjidhje?

**K.Bashkise:** Vec certifikates kerkohet AMTP dhe vetdeklarimi, pra qeveria jep disa opsione te gjeje zgjidhje qytetari.

**E.Zani:** Keni pyetje votojme?

**\*Miratohet pika 2 e rendit te ditës me 12 Vota PRO**

**Nuk Ka vota Kunder**

**Nuk ka Vota Abstenim**

Sekretari Këshillit

Khulia Gjini

Kryetari Këshillit

Enis Zani

Fatbardh Cekrezi

Adresa: Sheshi "Keshar Demushii" Bulvardi "10 Kashtori" Tiranë, 0612 2 2222 E-mail: keshillit@mmk.gov.al

Fatbardh Cekrezi

### Çështja 3

#### 3- Te Tjera.

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Visarion Bici, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kujtim Brahim, Alfrida Shahini, Visarion Bici, Kodhel Cala.

**E.Zani:** Propozoj që të shtrojmë si çështje propozimin e zëvendësimit të Anetarit të "Komisionit të Dhenies së Medaljeve dhe Titujve Vendore të Nderit". Automatikisht anetar mbas dorëheqjes së këshilltarit z.A.Ceci vjen në komision këshilltarja znj. Alketa Bici. Sipas ligjit dhe rregullores midis anetareve të komisionit do të zgjidhet Kryetari i këtij komisioni. Une bazuar në pervojën shumëvjeçare do të deshiroja të propozoja këshilltaren znj. Luljeta Dollani, anetare e këtij komisioni.

Votimi është i hapur për propozimin, jeni dakort?


**\*Miratohet propozimi i Kryetarit të Këshillit për zëvendësimin dhe zgjedhjen Kryetar të "Komisionit të Dhenies së Medaljeve dhe Titujve Vendore të Nderit", znj. Luljeta Dollani me 12 Vota PRO**

**Nuk Ka vota Kunder**

**Nuk ka Vota Abstenim**

Sekretari Këshillit

Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit

Enis Zani



Fatbardh Cekrezi

Edhela Gorgio

Kujtim Brahim

#### Çështja 4

#### 4- Te Tjera/Kerkesa te Qytetareve

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Ardina Hasa, Arnilda Dakare, Visarion Bici, Fatbardh Cekrezi, Greta Lena, Dalip Hazizaj, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini, Visarion Bici, Kodhel Cala.

**G.Lena:** Kemi administruar gjithë dosjen me kerkesat e qytetareve. Shumica jane ne mungese dokumentacioni, nga ato qe kemi vleresuar se jane per tu trajtuar me ndihme ekonomike jane sioas komisionit:

1-Ditjona Dermysi me tumor e operuar disa here dhe vazhdon me kimioterapi. Komisioni vlereson qe duhet trajtuar.  
2-Ligor Xhangolli ka 14 diagnoza me semundje te rende . i vetmi qe kontribonte ne familje ekonomikisht.

3-Egerta Topalli me tumor ne koke, nje nga rastet me te renda.

4-Hance Zeneli me tumor ne koke dhe gjoks.

5-Hurma Leshi e operuar 3 here nga zemra.

**K.Bashkise:** I kam kerkuar keshillit te jete racional dhe ne perputhje me ligjin, nuk ka as sens juridic as financiar. Fondi I Kontigjences eshte per raste fatkeqe emergjence (termete, zjarre, permbytje etj.)

(Vjen ne mbledhje Valbona Verushi)

Ne mbledhje marrin pjese 13 keshilltare.

**K.Bashkise:** Pra fondi eshte per emergjenca dhe katasrofa natyrore. sa me siper kemi shkrese te ardhur nga prefekti qe na kerkon konkretisht vendosjen parimisht te vendosjes se kriterëve dhe si do shperndahet ky fond.

**F.Cekrezi:** Kryetari ne menyre objektive thote dicka qe qendron, ng ate gjithë emrat qe citoi komisioni cilesoj Egerta Topalli, vajze e re , diagnoza kritike, shpenzime ne menyre te konsiderueshme. Lidhur me aktin e prefektit keto jane akte individuale, fondi reserve ben pjese te rastet specifike dhe emergjente. Jane edhe dy raporte nga KLSH lidhur me keto raste .

**E.Carciu:** Mesa shoh nga komisioni jane vleresuar vertet rastet me te renda une them ti kalojme.

**K.Cala:** Ky fond eshte percaktuar per raste te tjera, por edhe qytetareve duhet tu vijme ne ndihme. Une them te shtohet fondi .

**K.Bashkise:** Prefekti e thote qarte, percaktoni target grupin per rastet qe do te perdoret.

**A.Hasa:** Nese emrat vijne ketu ne do e ngrejme kartonin, por ky fond qe i merret bashkise duhet ti merret Ministrise.

**K.Bashkise:** Nuk ka asnje hapësire ligjore, mund te jemi bashkia e vetme ne Shqiperi qe shpenzojme lek per ilace.

**Dr.Ek:** Aktualisht eshte e pamundur te shtohet ky ze.

**V.Bici:** Kryetari ka te drejte por edhe ne kemi pergjegjesine tone per njerezit qe na kerkojne ndihme. Asnjehere nuk I kemi vene pikat mbi (i). per mua e mira do te ishte te shtohet ky fond.

**E.Zani:** Jeni dakort te bejme nje tjetër mbledhje jashte radhe? Me pare te mblidhen komisionet dhe e shtojme serisht ne Keshill?

(Vendoset te shqyrtohet ne nje tjetër mbledhje)

Sekretari Këshillit

Xhulja Gjini

Kryetari Këshillit

Enis Zani

Adresa: Sheshi "Zemher Dermysi" Bulevardi "10 Korrika" T41 Fax: 069 677746, mail: bashkaceramch@gmail.com